



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 05.03.2014  
Nr. 0204-273

**PËR:** Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë  
Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë

**LËNDA:** KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË, Nr. 01-013/267, të pranuar më datën 03.03.2014

Të nderuar,


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 01-013/267 të miratuar me datën 26.02.2014 nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si në vijim:

- Vendimi me Nr. 01-013/267, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Me respekt,

Slobodan Petrović,  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

  
**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

28-02-2014		
Nr.:	Org.:	Tera:
01-013/267		



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/1008, Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-ja, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 26. 02. 2014 aprovon këtë:

## V E N D I M

### për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

#### I

Me këtë vendim të Kuvendit të Komunës së Vitisë themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Vitisë.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka këtë përbërje:

1. Sokol Haliti - kryetar i Komunës së Vitisë, kryesues i KKS-së,
2. Xhafer Rexhepi - komandant i Stacionit të Policisë në Viti (anëtar),
3. Nexhmedin Jakupi - drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë (anëtar),
4. Isadete Hyseni - zyrtare për Barazi Gjinore (anëtare),
5. Qahil Sinani - drejtor i Drejtorisë për Arsim (anëtar),
6. Zoran Marinkovic - përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (anëtar),
7. Radovan Kociç - përfaqësues i Komitetit për Komunitete (anëtar),
8. Blerand Hasanaj - përfaqësues i FSK-së (anëtar),
9. Xheladin Halili - përfaqësues i Bashkësisë Islame në Viti (anëtar),
10. Jozef Marku - përfaqësues i Bashkësisë Katolike në Viti (anëtar),
11. Zvonko Kostic - përfaqësues i Bashkësisë Ortodokse në Viti (anëtar),
12. Xhemajl Hasani - përfaqësues i bizneseve në Komunën e Vitisë (anëtar),
13. Berina Muharemi - përfaqësuese e mediave lokale (anëtare),
14. Ibrahim Sefedini - OJQ "Elita" (anëtar),
15. Adnan Zenuni - kryetar i Komitetit Lokal të Qytetit të Vitisë (anëtar),
16. Bujar Ostrogllava - kryetar i Komitetit Lokal të Fshatit Pozheran (anëtar),
17. Agim Hasani - kryetar i Komitetit Lokal të Fshatit Smirë (anëtar),
18. Imri Emerllahu - përfaqësuesi i ekipit veprues për siguri në Bashkësi (anëtar),
19. Demush Mehmeti - përfaqësues i Këshillit të Prindërve të Nxënësve (anëtar).

#### II

Detyrat dhe funksioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për këshillat komunale për siguri në bashkësi nr. 27/2012 të MPB-së dhe 03/2012 të MAPL-së.

III

KKSB-ja është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të një komune.

IV

Gjatë themelimit të KKSB-së janë marr parasysh kriteret e përfaqësimit gjinor, përfaqësimi i drejtë i të gjitha bashkësive etnike dhe fetare.

V

Mandati i anëtarëve të KKSB-së është mandat i njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01 Nr \_\_\_\_\_  
Viti, 26 shkurt 2014

Kuvendi i Komunës së Vitisë

Kryesuesi:  
Naim Pira

